



Prishtinë, 09 shkurt 2010
Kodi i ZRRE-së: V_223_2010

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) të dhëna në Neneve 15, 26 dhe 31 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë të ndryshuar me Ligjin Nr.03/L-080;
2. Dispozitat e Nenit 37 të Rregullit për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë;
3. Dispozitat e Nenit 37 të Ligjit Nr. 02/L-123 për Shoqëritë Tregtare; dhe,
1. Kërkesën për vazhdim të licencës për furnizim/tregti me energji elektrike, të bërë me datë 04.12.2009 nga ndërmarrja "KORLEA INVEST A.S", adresa: **Jesenskèho 25, 040 01 Košice, Republika e Sllovakisë.**

Në mbledhjen e mbajtur më 09 shkurt 2010 nxori këtë:

VENDIM

- I. **VAZHDOHET** vlefshmëria e licencës për furnizim/tregti me energji elektrike e ndërmarrjes "KORLEA INVEST A.S", Nr.ZRRE_Li_26/07 për periudhën nga **14 janar 2010** deri më **14 janar 2012**.

Arsyetim

1. Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 04.12.2009 ka pranuar kërkesën e ndërmarrjes "KORLEA INVEST A.S" për vazhdim të licencës për Furnizim/Tregti me energji elektrike, e cila ndërmarrje ka qenë e licencuar në ZRRE prej datës **14 janar 2008** deri më **14 janar 2010**.
2. ZRRE ka vlerësuar aplikacionin e kompanisë në fjalë, dhe ka kërkuar plotësimin e dokumenteve që mungonin apo nuk përkonin me ato që kërkoheshin në Aplikacion.
3. Pas plotësimit të të gjithë dokumenteve dhe dëshmime të kërkuara sipas aplikacionit, ZRRE ka vlerësuar atë dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

4. Vazhdim i licencës për Furnizim/tregti me energji elektrike i lejon ndërmarrjes të kryej vetëm **aktivitetin e tregtisë** së energjisë elektrike. Ky vazhdim do të vlejë edhe për dy vjet tjera duke filluar nga data e skadimit të periudhës fillestare (14 janar 2010) të vlefshmërisë së licencës.
5. Nëse i Licencuari -“KORLEA INVEST A.S”, dëshiron të zhvillojë edhe aktivitetin e **furnizimit** me energji elektrike, të përcaktuar në Nenin 4 të licencës, ai duhet të ri aplikojë, duke plotësuar kushtet që nevojitet për këtë aktivitet, sipas udhëzimeve të ZRRE-së.
6. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.
7. Vendimi hyn në fuqi datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Kundër këtij Vendimi pala e pakënaqur mund të paraqesë ankesë në Gjykatën e juridiksionit përkatës brenda (14) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose nga data e publikimit të Vendimit në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së

Dr. Ali Hamiti, Kryesues

Theranda Beqiri, Anëtare

Dr. Nysret Avdiu, Anëtar

Përparim Kabashi, Anëtar

Blerim Koci, Anëtar